



Pranimi / Dorezimi Priljefti/Predata Received/Delivery	10.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtypja Puleg Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKIMBATCH	3384/2022		116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.428/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.428/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Ministrisë së Financave Punëve dhe Transfereve, në çështjen juridike "Kontestim konkursi kundër organit të punësimit Thesari i Kosovës/MFPT, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.428/2022 e datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet ne fuqi Vendimi me nr. 06/2022 i datës 13/04/2022 dhe vendimi nr. 12/2022 i datës 21.04.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës/MFPT.

## Arsyetim

Ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë financiar i pagesave* me numër reference RAN00008528 në Thesarin e Kosovës/MFPT.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 06/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN00004010 të ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe rrjedhimisht e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve.

Kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit, ankuesja me datë 15.04.2022 ka parashtruar ankesë të Njësia për Burime Njerëzore e Thesarit të Kosovës. Kjo e fundit me Vendimin me numër 12/2022 të datës 21.04.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja me datën 27.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2453/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit me Nr.12/2022 të datës 21.04.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 06.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit me datë 16.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2838/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e vendimarrjes, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2453/2022 të datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Prova shtesë lidhur me ankesën e ankueses e datës 29.04.2022; Raport për verifikimin e të dhënave të aplikuesit; Vërtetim i datës 12.04.2022 i lëshuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilin vërtetohet se ka diplomuar ; Formulari për mbrojtjen e punimit të diplomës master e datës 04.03.2022 me nr.01/96; Vendimi i datës 13.04.2022 me nr.06/2022; Ankesë e datës 15.04.2022 ; Vendim i datës 21.04.2022 me nr.12/2022; Akt emërimi i datës 01.07.2018 për periudhën provuese; Akt emërimi i datës 01.07.2019; Vendimi i datës 19.03.2021 e lëshuar nga Kryetari i Komunës së Podujevës; Vërtetim i datës 31.03.2022 me nr.13-72/2022; Vërtetim i datës 30.03.2022 me nr.13-71/2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 30.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Çertifikatë e datës 31.03.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Kopja e letërnjoftimit; Vërtetim i datës 05.04.2022 e lëshuar nga Policia e Kosovës; Çertifikatë e datës 15.04.2021; Diploma e datës 15.04.2016 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 16.05.2022 me numër protokollit 2538/2022; E-mail zyrtar i datës 10.05.2022; Kopja e konkursit e datës 29.03.2022-05.04.2022 me nr.ref,RN00008528; Aplikacioni i datës 01.04.2022 r rekomandimi për Lista e aplikantëve për pozitën Zyrtar i lartë financiar i pagesave; Aplikacioni i datës 05.04.2022 për Diploma Master e datës 24.01.2017 me nr.1078 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në



Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diploma bachelor e datës 31.10.2013 me nr.3623 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Akt emërimi i datës 11.04.2012; Diploma për kryerjen e shkollës së mesme e datës 11.06.2007; Çertifikatë e datës 12.03.2021; Çertifikatë e datës 29.01.2017; Çertifikatë e datës 12.10.2016; Çertifikatë e datës 23.04.2015; Raportim financiar i datës 26.01.2013; Çertifikatë e muaëshujtdhjetor 2017; Çertifikatë e datës 14.09.2012; Çertifikatë e datës 30.07.2012; Çertifikatë e datës 23.07.2012; Çertifikatë e datës 08.05.2012; Çertifikatë e datës 31.08.2010; Letër rekomandimi i datës 08.07.2015; Kopja e letërnjoftimit; Letër rekomandimi i datës 11.04.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 15.01.2022; Vendim për pushime të lehonisë i datës 17.08.2020; Vërtetim i datës 10.02.2022; Vërtetim i datës 07.04.2022; Çertifikatë e datës 06.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Aplikacioni L.S i datës 05.04.2022; Diploma Master e datës 08.08.2018 e lëshuar nga Kolegji UBT Prishtinë; Diploma bachelor e datës 19.12.2012 e lëshuar nga Kolegji UBT Prishtinë; Kopja e Letërnjoftimit; Akt emërimi i datës 24.07.2015; Çertifikatë e datës 24.12.2017; Çertifikatë e datës 12.04.2017; Çertifikatë e datës 12.11.2016; Çertifikatë e datës 10.11.2011; Çertifikatë e datës 15.04.2011; Çertifikatë e datës 15.01.2011; Çertifikatë e datës 07.07.2009; Çertifikatë e datës 03.02.2011; Çertifikatë e datës 06.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës; Diploma e shkollës së mesme 07.06.2008; Referencë e datës 04.03.2015 e lëshuar nga NTSH REMO.COM; Referencë e datës 28.03.2015; Vërtetim i datës 27.03.2015; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 07.02.2019; Vërtetim i datës 05.04.2022; Vërtetim i datës 08.04.2022; Aplikacioni i datës 01.04.2022 për M.K; Diploma Master e datës 28.12.2022 me nr.232 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma Bachelor e datës 16.06.2011 me nr.1825 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma e shkollës së mesme e datës 24.05.2002; Letër rekomandim e datës 28.07.2010; Letër rekomandim i datës 07.10.2019; Vërtetim i datës 15.09.2005; Vërtetim i datës 01.11.2019; Vërtetim i datës 04.06.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Çertifikatë e datës 24.09.2021; Çertifikatë e vitit 2017; Çertifikatë e datës 08.09.2015; Çertifikatë e datës 18.01.2013; Çertifikatë e datës 29.05.2018; Çertifikatë e datës 16.11.2007; Çertifikatë e datës 08.12.2010; Vërtetim i datës 14.06.2021; Çertifikatë e datës 28.03.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 23.03.2022; Aplikacioni i datës 05.04.2022 për V.V; Diploma e datës 10.02.2016 me nr.1612 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 22. 03.2019; Çertifikatë e vitit 2021-2023 për prokurim; Vërtetim i datës 22.02.2022; Diploma e shkollës së mesme e datës 21.05.2001; Vërtetimi i kopjes nga origjinali te noteri me datë 07.03.2019; Kopja e letërnjoftimit ; ; Dëshmi mbi përvojën e punës 31.10.2006; Vërtetim i datës 01.04.2021; Shkresë e datës 01.09.2015 e lëshuar nga Pro Credit Bank; Shkresë e datës 30.03.2017 e lëshuar nga TEB; Kontratë për kohë të caktuar e datës 02.10.2017 BPB; Akt emërimi i datës 30.12.2019; Referencë e datës 25.10.2006; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Vendimi i datës 13.04.2022; Njoftimi për listën e ngushtë e datës 13.04.2022 dhe vendimi i datës 21.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 14.03.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për *lëvizje brenda kategorisë* për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë financiar i



pagesave" me numër reference RN00008528, në Thesarin e Kosovës. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara:

**Arsimi i kërkuar:** Diploma e studimeve universitare në Fakultetin *Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diplomën Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor;*

**Përvoja e punës:** *së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.*

Sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "*Zyrtar i Lartë financiar i pagesave*" me numër reference RN00008528 në Thesarin e Kosovës, mirëpo Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 06/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN00004010 të ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve. Rrjedhimisht ankueses me bazë të njëjte i është refuzuar edhe ankesa e parashtruar kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "*Zyrtar i Lartë financiar i pagesave*" sepse e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe për këtë ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme si Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, si dhe Vërtetimin që dëshmon se ka diplomuar me datë 04.03.2022, dokumente këto të nënshkruara, vulosura dhe protokolluara nga Fakulteti Ekonomik - Universiteti i Prishtinës "*Hasan Prishtina*". Ankuesja thekson se për shkak të procedurave të brendshme administrative ende nuk është përgatit diploma e studimeve master dhe se nuk ka mundur ta sjell të njëjtën, mirëpo e njëjta konsideron se ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që vërtetohet se ka përfunduar studimet master me date 04.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha se bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesja ka përfunduar studimet themelore me datë 11.03.2016 dhe ka marrë titullin Bachelor për Ekonomik me gjithsej 180 kredi/ECTS, dhe kjo është vërtetuar përmes Diplomës me numër 6367 të datës 05.04.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "*Hasan Prishtina*". Ndërsa lidhur me përfundimin e studimeve master ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ka dorëzuar si dëshmi vetëm Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, të datës 04.03.2022, ndërsa me vonë gjate procesit të shqyrtimit të ankesës ankuesja ka dorëzuar si dëshmi edhe Raportin për verifikimin e të dhënave të aplikuesit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimin me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "*Hasan Prishtina*".

Kolegji vlerëson se Formulari për mbrojtjen e punimit të diplomës master, i datës 04.03.2022, i dorëzuara nga ankuesja me rastin e aplikimit, mund të shërbejë si dëshmi për nevoja të brendshme të Fakultetit, gjegjësisht Universitetit, por jo edhe për nevoja të punësimit, sepse me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht nenin 135 përcaktohet se: *Përfundimi i suksesshëm i*



*studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.*

Ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës i është referuar edhe dy dokumenteve tjera si Raportit për verifikimin e të dhënave të aplikuesit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimit me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe pretendon se këto dokumente kanë qenë dëshmi e mjaftueshme përmes të cilave vërtetohet përfundimi i studimeve master, mirëpo Kolegji ka gjetur se të dy këto dokumente të cilave ju referohet ankuesja mbajnë datën e lëshimit 08.04.2022 gjegjësisht 12.04.2022, pas datës së fundit të mbylljes së konkursit që ishte data 06.04.2022, ndërsa me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nën 10 paragrafi 2 përcaktohet se: 2. *Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.2 Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".*

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022 nuk ka sjellë dëshmi të duhura për vërtetimin e përfundimit të studimeve master, nga autoriteti kompetent, në këtë rast Universiteti i Prishtinës, dhe në këtë mënyrë nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohej: *Arsimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare në Fakultetin Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diploma Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor.* Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.06/2022 të datës 13.04.2022 për refuzimin e aplikacionit të ankueses dhe Vendimin me numër 12/2022 të datës 21.04.2022 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.428/2022, datë 10/06/2022

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

